



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

# RAPORT VJETOR 2013





ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

**SKY TOWER**

**Rr. "Ibrahim Rugova"**

**Nr. 5, Ap 9/3**

**Tiranë, Shqipëri**

**Përgatitur nga: Sekretariati i AAB**

**Design & Layout: Ladybird Creations**

**Shtypi: Gentgrafik**



## MESAZH NGA KRYETARI

Sistemi bankar shqiptar u rrit me 4 për qind në vitin 2013, ndërkohë që kreditë e disbursuara u ulën, për herë të parë, me 2 për qind. Kreditë me probleme vijuan të rriten, megjithëse me ritme shumë më të ulëta, dhe viti u mbyll me një raport të tyre ndaj totalit të kredive prej 23.5 për qind. Pavarësisht treguesve të zymtë të biznesit, sistemi mbetet gjithsesi likuid dhe i mirëkapitalizuar.

Ekziston një ndjesi e përgjithshme që më e keqja mund të ketë kaluar. Vendi i përjetoi zgjedhjet parlamentare dhe ndryshimin e qeverisë qetësisht dhe paqësisht. Arritja më e madhe e qeverisë së re është marrëveshja me FMN-në, që së bashku me Bankën Botërore dhe BE, do të mundësojnë financimin afat gjatë aq të nevojshëm, i cili do të rigjallërojë ekonominë. Ne kemi filluar të ndjejmë, për shembull, impaktin pozitiv të shlyerjes nga qeveria të pagesave të vonuara të detyrimeve.

Programi i FMN-së përcakton gjithashtu disa reforma, të cilat janë të mirëpritura nga komuniteti bankar, si edhe rritjen e tatimit mbi të ardhurat personale dhe të bizneseve, çka nuk është e mirëpritur. Rritjet e taksave supozohej të shoqëroheshin me administrim më të mirë të mbledhjes së tyre, që ende nuk është realizuar. Pjesa më e madhe e bankave në vend, të gjitha tatimpaguese shembullore në çdo drejtim, gjenden në një mënyrë ose një tjetër në mosmarrëveshje me autoritetet tatimore, në nivel administrativ ose gjyqësor. Kjo është absurde dhe ne shpresojmë se arsyeja do të mbizotërojë sa më parë.

Trajnimet vijuan të ishin në fokusin e Shoqatës gjatë vitit 2013 dhe kështu duhet të jetë edhe në vitet e ardhshme. Jo vetëm sepse të gjitha bankave u duhen bankierë më të mirë, por edhe sepse trajnimi është një nga të paktat çështje të pakontestueshme, për të cilën të gjitha bankat mund të kontribuojnë e prej të cilës të gjitha përfitojnë.




Duhet të pranojmë se Shoqata dështoi në përpjekjet për krijimin e një funksioni të fortë dhe të pavarur ekzekutiv, që të administrojë aktivitetet e saj. Ajo ende udhëhiqet nga një bord drejtues i përbërë nga drejtuesit ekzekutivë të disa prej bankave anëtare. Kjo krijon mundësi konflikti interesash dhe mungese të dedikimit me kohë të plotë. Unë mbetem optimist gjithsesi, që Shoqata do ta zgjidhë këtë problem shumë shpejt. Vetëm nëpërmjet një funksioni ekzekutiv të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm, AAB do të jetë më e fortë dhe zëri i bankave do të dëgjohet e të drejtat e tyre do të mbrohen.

Në mbyllje, dëshiroj të falënderoj kolegët e mi të Shoqatës, Sekretariatit dhe stafin e AAB-së për kontributin e tyre.

Seyhan PENCABLIGIL  
Kryetar

# STRUKTURA ORGANIZATIVE E AAB-së



# BORDI DREJTUES I AAB (NË FUND TË MAJIT 2014)



Z. Seyhan PENCABLIGIL  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Banka Kombëtare Tregtare  
Kryetar



Z. Ioannis KOUGIONAS  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Banka NBG Albania  
Zëvendës Kryetar



Z. Frédéric BLANC  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Banka Societe Generale  
Albania  
Anëtar



Z. Christian CANACARIS  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Banka Raiffeisen Shqipëri  
Anëtar



Z. Periklis DROUGKAS  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Alpha Bank Albania  
Anëtar



Z. Bozhidar TODOROV  
Drejtore i Përgjithshëm,  
Fibank Shqipëri  
Anëtar

# ANËTARËSIMET E AAB

AAB është anëtare me të drejta të plota ose anëtare e asociuar në organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare, si më poshtë:

- i. Anëtarësimet Ndërkombëtare
  - Federata Evropiane e Bankave (EBF)
  - Forumi Ndër-Ballkanik i Shoqatave të Bankave
  - Shoqata e Bankave për Evropën Qendrore dhe Lindore (BACEE)
  - OECD Rrjeti Ndërkombëtar mbi Edukimin Financiar (INFE)
- ii. Anëtarësimet Kombëtare
  - Këshilli Ekonomik Kombëtar
  - Këshilli Tatimor
  - ICC Albania – Komiteti Kombëtar i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC)
  - Këshilli Kombëtar i Punës
  - Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA)





# SEKTORI BANKAR SHQIPTAR NË VITIN 2013

Viti 2013 ishte një vit i vështirë për ekonominë shqiptare e cila ngadalësoi rritjen e saj në mënyrë të ndjeshme. Aktiviteti bankar i reflektoi sfidat me të cilat u përball ekonomia dhe u karakterizua nga ulja e kreditimit dhe rritja e kredive me probleme. Megjithatë, treguesit e tjerë të rëndësishëm të mbarëvajtjes financiare u përmirësuan gjatë vitit 2013. Kështu, rezultati financiar i sistemit pati rritje, ndërkohë që treguesit e kapitalizmit dhe likuiditetit ishin dukshëm mbi kërkesat minimale rregullatore.

Sektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital të gjithin privat, dhe me mbizotërim të bankave të huaja me qendra në vendet e Bashkimit Europian.

Volumi i aktivitetit të sektorit bankar, në terma të bilanceve të bankave, u rrit gjatë vitit 2013, megjithëse në përqindje më të ulëta sesa në vitet e mëparshëm, si rezultat i rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe rënies së kreditimit.

Në fund të vitit 2013, aktivet totale të bankave ishin rreth 1,234 miliardë Lekë, dhe përfaqësonin rreth 91.1 për qind të PBB-së, pas një rritjeje vjetore prej rreth 3.9 për qind. Rritja e aktiveve ishte kryesisht rezultat i aktivizimit të bankave në tregun ndërbankar dhe në tregun e letrave me vlerë të qeverisë.

## Ecuria e treguesve kryesorë të sistemit bankar shqiptar

Treguesi	2011	2012	2013
Aktivet Totale (në miliardë Lekë)	1,120.2	1,187.9	1,234.3
në % mbi PBB	84.6%	89.4%	91.1%
Depozitat Totale (në miliardë Lekë)	924.1	991.7	1,025.6
në % mbi PBB	69.8%	73.3%	75.7%
Kredia për Ekonominë (në miliardë Lekë)	566.2	577.8	567.2
në % mbi PBB	42.8%	42.7%	41.8%
Kapitali i Aksionerëve (në miliardë Lekë)	97.3	101.8	103.3
ROE (in %)	0.8	3.8	6.4
ROA (in %)	0.1	0.3	0.5

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për financimin e aktivitetit, faktori kryesor mbeten depozitat, të cilat përbëjnë rreth 82.1 për qind të të gjithë detyrimeve të sektorit bankar. Pavarësisht rënies së aktivitetit ekonomik në vend, depozitat u rritën me 3.4 për qind gjatë vitit 2013, përkundrajt një rritjeje me 7.3 për qind një vit më parë, duke arritur në fund të vitit një total prej 1,026 miliardë Lekë.

Rritja e totalit të depozitave u mbështet si nga rritja në depozitave të individëve ashtu edhe nga rritja e depozitave të bizneseve. Në fakt, depozitat e bizneseve shënuan një rritje prej 5.9 për qind gjatë vitit 2013, ndërkohë që paraqiteshin në rënie një vit më parë.

## RËNIA E KREDITIMIT DHE RRIJTJA E KREDIVE ME PROBLEME

Normat e rritjes së kreditimit u ngadalësuan shumë gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, dhe u kthyen në negative gjatë tremujorit të dytë, duke rezultuar në një ulje të portofolit të kredive prej 1.8 për qind përgjatë gjithë vitit. Kreditë bankare u përqendruan në sektorin e bizneseve të cilat përthithën rreth 73 për qind të kredive në vitin 2013, ndërmjet të cilave vetëm bizneset e mëdha zënë rreth 43 për qind. Bankat vazhdojnë të përballohen me kërkesë shumë të ulët si rrjedhim i pasigurive për zhvillimet afat-shkurtra ekonomike në Shqipëri. Bizneset dhe individët vazhduan të mbeten të tërhequr ndaj aktivitetit në të tilla kushte pasigurie, dhe bankave u munguan projekte të mira e potenciale financimi.

Kreditë me probleme vazhduan të rriten gjatë vitit 2013, megjithëse me ritme shumë më të ulëta se ato të viteve të mëparshëm, duke arritur në fund të Dhjetorit 2013 në 23.5 për qind të totalit të portofolit të kredive, përkundrejt 22.5 që ishte kjo shifër Dhjetorin e kaluar. Një nga arsytet për rritjen e këtij raporti aritmetikisht është edhe rënia në shifrën e totalit të kredive në fund të vitit 2013.

Rezultati financiar i sistemit bankar për vitin 2013, llogaritur sipas standardeve të Bankës së Shqipërisë, ishte rreth 6.6 miliardë Lekë. Të ardhurat nga interesat vazhduan të binin, në vijim të rënies së përgjithshme të normave të interesit, ndërsa të ardhurat nga aktivitete të tjera u rritën, duke u bërë edhe burimi i dytë më i rëndësishëm i të ardhurave për sektorin bankar (me rreth 33 për qind të totalit të të ardhurave).

## TREGUES TË FORTË TË KAPITALIT DHE LIKUIDITETIT

Sektori bankar shqiptar vazhdoi të ishte i mirëkapitalizuar, dhe për rrjedhim i aftë të përballojë sfidat aktuale ekonomike, në vend e në arenën ndërkombëtare. Përgjatë vitit bankat rritën më shumë kapitalin e tyre sesa aktivet e ponderuara me rrezik, duke mundur kështu një përmirësim të mëtejshëm të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin prej 17.96 për qind në fund të vitit 2013, krahasuar me 16.2 për qind në fund të vitit 2012, ndërkohë që kërkesa minimale rregullatore për këtë tregues vazhdoi të ishte 12 për qind.

Bankat u karakterizuan nga tregues të fortë likuiditeti përgjatë vitit 2013, dukshëm mbi nivelet rregullatore të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Në fund të vitit, raporti i aktiveve likuide përmbi detyrimet afatshkurtra për të gjithë sistemin ishte 34.7 për qind për të gjithë monedhat (42.7 për qind për monedhën vendase dhe 27.5 për qind për monedhat e huaja), ndërkohë që nivelet minimale të përcaktuara nga Autoriteti ishin në nivelet 25 për qind për të gjithë monedhat dhe 20 për qind për monedhat e huaja e atë vendase veçmas.

## SHPËRNDARJA E RRJETIT DHE SHËRBIMEVE

Megjithëse një vit i vështirë në shumë drejtime, viti 2013 nuk shënoi ndonjë zvogëlim të ndjeshëm të aktivitetit të bankave në këndvështrimin e shërbimeve dhe lehtësirave që ato u ofruan klientëve.

### Rrjeti i bankave

Tregues	2011	2012	2013
Nr. i degëve dhe agjencive të bankave	553	556	549
Nr. i ATM-ve	805	823	822
Nr. i POS-eve	5,126	5,307	5,668
Nr. i Kartave	731,851	768,982	805,560
Debit	693,958	719,809	741,128
Kredit	37,893	49,173	64,432
Nr. i transaksioneve Internet Banking	187,431	236,215	323,676

Burimi: Banka e Shqipërisë, AAB

Ecuria pozitive në rritjen e numrit të kartave të kreditit dhe të debitit, e shoqëruar me rritjen e produkteve bankare dhe transaksioneve bankare nëpërmjet internetit vijoi edhe gjatë vitit 2013. Në fund të vitit, numri i llogarive bankare të klientëve të bankave u rrit me 7.1 për qind, krahasuar me një rritje prej 3 për qind gjatë vitit 2012. Gjatë këtij viti u dyfishua në krahasim me vitin 2012 edhe numri i llogarive të klientëve të aksesueshme nga interneti.

14 nga 16 bankat që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri ofrojnë shërbimin e lëshimit të kartave, ndërkohë që 7 prej tyre janë aktive edhe në lëshimin edhe në pranimin e transaksioneve me karta (nëpërmjet pajisjeve POS). Vetëm gjatë vitit 2013, numri i kartave në qarkullim u rrit me 5 për qind ndërsa numri i pajisjeve POS u rrit me 7 për qind. Transaksionet me karta u rritën në vitin 2013 me rreth 7.7 për qind në numrin e tyre dhe rreth 5.4 për qind në volum.

Edhe shërbimet e ofruara për mundësimin e bankingut nëpërmjet internetit kanë arritur duke u rritur që prej futjes së tyre të parë në treg në vitin 2005. Aktualisht, 12 nga 16 bankat në vend ofrojnë *internet banking*, ndërkohë që 6 prej tyre kanë ndërmarrë ose po ndërmarrin iniciativa për futjen e *mobile banking*, si dhe shërbime të tjera si *MultiCash*, *SMS banking*, apo bashkëpunime me institucione financiare jo banka në vend që ofrojnë shërbime të pagesave nëpërmjet telefonit celular. Në vitin 2013, numri i transaksioneve bankare të kryera nëpërmjet internetit u rrit me 37 për qind. Vlera e këtyre transaksioneve ka qenë në rënie, çka tregon një ndryshim të tipit të klientëve që përdorin këto shërbime, nga biznese në individë.

# NDRYSHIME NË KUADRIN RREGULLATOR



## RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Paketë masash ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë

“Për Licencimin, Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Operatorëve të Skemave Kombëtare të Pagesave me Kartë”

“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”

“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”

01



## LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE MIRATUAR NGA PARLAMENTI

“Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”

“Për sistemin e pagesave”

“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat””

02

Gjatë vitit 2013 kuadri rregullator dhe legjislativ pësoi disa ndryshime të rëndësishme të cilat ndikuan në aktivitetin e sektorit bankar. Autoritetet i ndërморën këto ndryshime kryesisht me qëllim rritjen e kredihënies për sektorin privat dhe zgjidhjen e problematikës së krijuar nga rritja e kredive me probleme në ekonomi.

## I. RREGULLORET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Më 27 Mars 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi një **paketë masash** me synim nxitjen e kreditimit nga sistemi bankar, që përfshiu ndryshime në tre rregullore të rëndësishme, përkatësisht:

- Ndryshimet në Rregulloren **“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”**, që konsistojnë në dy pjesë: së pari, reduktimi (në zero) i koeficientëve të rrezikut të aplikuar në huatë e reja, në rast se bankat do të rrisin huadhënien brenda intervalit 4% -10%. Kjo masë u jep mundësi bankave të rrisin aktivitetin e tyre huadhënës, pa nevojën e injektimit të kapitalit shtesë. Së dyti, u rrit (në 100%) koeficienti i rrezikut për investimet e bankave në valutë të huaj jashtë vendit.
- Ndryshimet në Rregulloren **“Për administrimin e rrezikut të kredisë”** përcaktojnë kategorizimin e kredive të ristrukturuara si kredi e mirë që do të ponderohet me rrezik 10%, si dhe shkurtimin e periudhës së nevojshme për riklasifikimin e këtyre kredive nga 9 muaj në 6 muaj. Kjo masë ka për qëllim të lehtësojë ristrukturimin e shëndetshëm të kredive ndaj huamarrësve me vështirësi të përkohshme në shlyerjen e detyrimeve të tyre, si dhe të lehtësojë nevojën për kapital shtesë që e shoqëron ristrukturimin.
- Ndryshimet në Rregulloren **“Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”** ishin kryesisht një korrigjim i treguesve të likuiditetit, në nivelet e mëparshme të raportit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra, në nivelin minimal prej 20% për të gjitha monedhat, dhe 15% llogaritur veçmas për monedhat e huaja dhe Lekun.

Më 26 Qershor 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin Nr. 42 Rregulloren **“Për Licencimin, Rregullimin dhe Mbikëqyrjen e Operatorëve të Skemave Kombëtare të Pagesave me Kartë”**. Kjo Rregullore synon të garantojë sigurinë, stabilitetin, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e skemave kombëtare të pagesave me kartë si një element i rëndësishëm i sistemit të pagesave me vlerë të ulët, duke krijuar kriteret dhe procedurat për licencimin e operatorëve të skemave kombëtarë të pagesës me kartë në Shqipëri, si dhe duke formalizuar mbikëqyrjen e këtyre operatorëve.

Më 31 Korrik 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi me vendimin Nr. 48 Rregulloren e re **“Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”**. Kjo Rregullore përcakton kriteret dhe rregullat për llogaritjen e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe minimumin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, në përputhje me standardet e Basel II dhe Direktivës së IV të BE-së mbi Kërkesat për Kapitalin. Bankat duhet të sigurojnë që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, llogaritur sipas kriterëve të përcaktuara në këtë Rregullore të jetë jo më pak se 12%.

Më 28 Gusht 2013, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi vendimin Nr. 55 “Për ndryshime në rregulloren “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit””. Këto ndryshime në vijim të reflektimit të ndryshimeve të bëra në Ligjin “Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Këshillit të Evropës MONEYVAL. Ndryshimet kryesore u janë bërë neneve që rregullojnë procedurat dhe dokumentacionin për identifikimin e klientëve për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, strukturat përgjegjëse të subjekteve, raportimin tek autoritetet, etj..

Gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë miratoi disa Rregullore në lidhje me qarkullimin dhe trajtimin efikas të monedhave dhe kartëmonedhave, me ndikim të menjëhershëm në veprimtarinë e bankave, dhe përkatësisht:

- Vendimi Nr. 15, datë 13.02.2013, për miratimin e Rregullores “Për kontrollin për autencitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare”;
- Vendimi Nr. 41, datë 26.06.2013, për miratimin e Rregullores “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare, të dyshuara të falsifikuara”;
- Vendimi Nr. 49, datë 31.07.2013, për miratimin e Rregullores “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja, të dyshuara të falsifikuara”;
- Vendimi Nr. 57, datë 11.09.2013, për miratimin e Rregullores “Për këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare të dëmtuara”;
- Vendimi Nr. 82, datë 16.12.2013 “Për një ndryshim në Rregulloren “Për kontrollin për autencitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare””. Ndryshimi konsiston në aprovimin e makinave për trajtimin e kartëmonedhave, të instaluar para hyrjes në fuqi të Rregullores, për përmbushjen e kërkesave të parashtruara në të.

## II. LIGJE DHE AKTE NËNLIGJORE MIRATUAR NGA PARLAMENTI

Më 18 Prill 2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 122/2013 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”. AAB u përfshi gjërësisht në procesin e konsultimit, duke mbledhur dhe përcjellë komentet dhe sugjerimet e sistemit bankar mbi projekt-ndryshimet e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë, dhe duke lobuar në Ministri dhe Komisionin Parlamentar përkatës për marrjen e tyre në konsideratë. Ndryshimet më të rëndësishme, që ndikojnë veprimtarinë e bankave, ishin ndryshimet në nenet e Kodit të lidhura drejtpërdrejtë me ekzekutimin e kontratave bankare, me qëllim rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të kolateralit, si: heqja e të drejtës gjykatave për të ndërhyrë në mekanizmin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, të tilla si kredi bankare, për të cilat është lëshuar ndërkohë urdhri i ekzekutimit; rritja e transparencës gjatë procesit të ankandit të pronave kolateral; dhe vendosjen e një afati procedural për ankimimet kundër procedurave të përmbarrimit.

Më 29 Prill 2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 133/2013 **“Për sistemin e pagesave”**. Ligji përcakton standardet kryesore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e komponentëve të rëndësishme të sistemit të pagesave brenda Shqipërisë, si dhe rregullat për mbrojtjen e sistemeve. Banka e Shqipërisë, në kryerjen e detyrave të saj të përcaktuara në këtë Ligj, do të bashkëpunojë me autoritetet vendase apo / dhe të huaja, për të shkëmbyer informacione, dhe për të koordinuar aktivitete ose marrëveshje të tjera bashkëpunimi, sipas nevojës.

Më 29 Prill 2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin **“Për disa ndryshime në ligjin “Për barrët siguroese”**”. Këto ndryshime kanë shfuqizuar konceptet e kolateralit, terma të cilat nuk janë të rregulluara në Ligjin “Për Sistemin e Pagesave”, duke krijuar kështu një vakum në kornizën ligjore sipas të cilës bankat veprojnë në lidhje me këto lloje aktivesh të vendosura si kolateral. AAB u është drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë me kërkesën për korrigjimin e këtij hendeku.

Më 28 Dhjetor 2013, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 177/2013 **“Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”**”. Me këtë Ligj bëhen ndryshime të rëndësishme në nivelin dhe grumbullimin e tatimit mbi të ardhurat, të tilla si rritja e tatimit mbi fitimin në 15%. Një tjetër ndryshim i rëndësishëm në Ligj, që ndikon drejtpërdrejtë veprimtarinë bankare, ishte ndryshimi sipas të cilit rezervat e krijuara nga bankat për provigjionimin e kredive do të njihen si shpenzime sipas standardeve të SNRF/SNA.

## AKTIVITETET E AAB-së





## I. KOMITETET TEKNIKE

Seksioni i mëposhtëm përmbledh çështjet kryesore të trajtuara nga tetë Komitetet Teknike të AAB-së gjatë vitit 2013. Në total, **Komitetet e AAB-së dhe grupet e punës të krijuar brenda e midis tyre u mblodhën në 34 takime përgjatë vitit 2013**, për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat mbi çështje si operacionale ashtu edhe ligjore apo vendimmarrjeje, të cilat u ndoqën në vijim nga Sekretariati i AAB-së.

### I. KOMITETI KUNDËR MASHTRIMEVE ME KARTA

Komiteti forcoi më tej gjatë këtij viti marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me Master Card dhe Visa, sidomos me praninë e kësaj të fundit në mbledhjet e Komitetit. Ky bashkëpunim ishte gjithashtu i rëndësishëm në organizimin nga AAB dhe Komiteti Kundër Mashtrimit me Karta, për të tretin vit të tretë radhazi, të Forumit Kombëtar të Kartave, më 17 Maj 2013, që këtë vit u përqendrua jo vetëm në parandalimin e mashtrimeve me karta, por edhe në zhvillimin dhe mundësitë për biznesin me karta dhe inovacioneve në këtë fushë.

Një nga çështjet e diskutuara nga Komiteti gjatë vitit ishte krijimi për herë të parë nga Banka e Shqipërisë, të kuadrit rregullator të veprimtarisë së skemave kombëtare të pagesave me karta, duke kontribuar në procesin e konsultimit me palët e interesit, të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në këtë drejtim.

Gjatë këtij viti, anëtarët e Komitetit shkëmbyen informacion dhe diskutuan, si në takimet e mbajtura ashtu edhe nëpërmjet komunikimit elektronik, mbi raste apo tentativa për mashtrim në ATM-të e bankave, si dhe bashkëpunuan me Komitetin e AAB për Sigurinë Bankare për ti identifikuar e adresuar këto raste në mënyrën e duhur në Policinë e Shtetit, për hetimin dhe ndjekjen e tyre penale, si dhe për parandalimin e tentativave të ngjashme në të ardhmen. Në këtë kuadër, Komiteti diskutoi gjatë vitit edhe me çështje të lindura gjatë përdorimit të kartave në internet apo të lidhura me *e-commerce*.



## ii. KOMITETI I SIGURISË BANKARE

Në fillim të vitit Komiteti vendosi mbi planin e punës për vitin 2013 dhe zgjodhi Kryetarin e ri, Z. Roland Tashi, Koordinator i Sigurisë Fizike në ProCredit Bank Shqipëri. Komiteti mbështeti Sekretariatit e AAB-së në organizimin e Forumit të Dytë Kombëtar të Sigurisë Bankare, që u zhvillua në Maj në Hotel Tirana International. Forumi kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë e bankave, lidhur edhe me përmirësimin e administrimit dhe trajnimeve.

Gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri dhe në muajt në vijim, anëtarët e Komitetit bashkëpunuan për të rritur nivelin dhe masat e sigurisë në bankat përkatëse. Ata organizuan takime me drejtorë të Policisë dhe disa prej drejtorët e Shoqërive të Ruajtjes së Sigurisë Fizike në rrethin e Fierit dhe të Vlorës, për të bashkëpunuar dhe për të parandaluar tendencat kriminale gjatë sezonit të verës.

Komiteti ndoqi gjatë vitit programin e takimeve të planifikuar paraprakisht, si të vetë anëtarëve të tij ashtu edhe me palë të tjera, si dhe kontribuoi në pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga AAB.



## iii. KOMITETI I AUDITORËVE TË BRENDSHËM TË BANKAVE

Gjatë vitit 2013 Komiteti rriti bashkëpunimin me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA), si nëpërmjet trajnimit të organizuar së bashku në këtë fushë ashtu edhe përmes krijimit të mundësive për auditorët e brendshëm të bankave për të mësuar më shumë mbi provimet për CIA (Certifikim i Auditorëve të Brendshëm) që tanimë Instituti mund t'i organizojë në Shqipëri. Shumë prej auditorëve të brendshëm të bankave janë tashmë anëtarë të AIIA dhe janë duke aplikuar për kryerjen e provimeve.

#### iv. KOMITETI I PËRPUTHSHMËRISË

Komiteti i Përputhshmërisë së AAB-së gjatë vitit diskutoi dhe kontribuoi me komente mbi aktet normative të hartuara dhe miratuara nga Banka e Shqipërisë për parandalimin e pastrimit të parave, si edhe për çështje të lidhura me zbatimin e disa prej rregulloreve të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Komiteti arriti në një bashkëpunim të frytshëm në fund të vitit me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave Vendore në Tiranë, për lehtësimin e procesit të ekzekutimit nga bankat të urdhrave të bllokimit në llogaritë bankare për shlyerjen e detyrimeve të tatimpaguesve, nëpërmjet komunikimit elektronik të informacionit dhe të urdhrave të bllokimit.

Në vijim të bashkëpunimit shumë të mirë të vendosur tashmë me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Komiteti i Përputhshmërisë pati gjatë vitit disa komunikime me këtë institucion, si edhe dy tryeza të rrumbullakëta ku pjesëmarrësit diskutuan për çështje konkrete dhe problematika lidhur me punën e vazhdueshme të të dy palëve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Komiteti ka pasur në fokus gjatë këtij viti edhe implementimin e projektit FATCA në Shqipëri, veçanërisht në lidhje me qasjen që do të ndiqet ndaj këtij projekti nga të gjitha bankat anëtare.

#### v. KOMITETI I BURIMEVE NJERËZORE

Komiteti u mbledh në secilin tremujor gjatë vitit 2013. Një nga objektivat e tij kryesorë për vitin ishte zhvillimi i funksionit të burimeve njerëzore në bankat individuale. Komiteti u takua në Mars me përfaqësuesit e PWC Rumani për të diskutuar mbi teknikat e reja për zhvillimin e profesionit të burimeve njerëzore në industrinë bankare në Shqipëri. Një nga arritjet e Komitetit ishte pjesëmarrja e bankave shqiptare në Vrojtimin mbi Pagat, organizuar nga Hay Group, për të dytin vit radhazi.

AAB organizoi në Prill një takim të Komitetit me përfaqësues të Bankës Shqipërisë lidhur me zbatimin e rregullores “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, ku pjesëmarrësit sqaruan çështje lidhur me zbatimin e disa neneve të veçanta të rregullores.

Në drejtim të përmirësimit të funksionit të AAB-së për ngritjen e kapaciteteve njerëzore të bankave anëtare, Komiteti miratoi një procedurë të re të organizimit të trajnimeve që do të respektohet nga të gjitha bankat në lidhje me trajnimet e zhvilluara nga AAB.

Në Nëntor Komiteti ndërmori iniciativën për krijimin e një bazë të dhënash me tregues kryesorë të burimeve njerëzore (HR KPI) në bankat anëtare që përfshijnë matës kryesorë të fuqisë punëtore dhe masa referimi të industrisë bankare. Kjo bazë të dhënash shërben për bankat pjesëmarrëse si një mjet për krahasimin e performancës së tyre në burimet njerëzore me nivelet mesatare të sistemit, dhe mbështet departamentet e burimeve njerëzore në çdo bankë për hartimin e strategjive të reja në këtë fushë. Ky proces u menaxhua nga Sekretariati i AAB-së me mbështetjen e Departamentit të Burimeve Njerëzore të BKT-së dhe kontributin e të gjithë bankave anëtare.

## vi. KOMITETI I SIGURISË SË INFORMACIONIT

Komiteti i Sigurisë së Informacionit është mbledhur disa herë gjatë këtij, si ndërmjet anëtarëve të tij, ashtu edhe me palë të treta. Drejtuesit e Qendrës PROTİK (një Qendër burimore e teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve) mbajtën një prezantim në një nga takimet e Komitetit ku prezantuan synimet dhe aktivitetet e Qendrës si edhe mundësitë e bashkëpunimit me Komitetin.

Në Prill anëtarët zgjodhën Kryetarin e ri të Komitetit, Z. Akil Ndrenika Oficer Sigurie IT në BKT, dhe diskutuan mbi zbatimin e Udhëzimit të miratuar rishtas “Për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit në rast të delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimi i një marrëveshje të veçantë në rastet e këtij delegimi”. Me mbështetjen e Komitetit, Sekretariati i AAB-së organizoi një trajnim të suksesshëm mbi Sigurinë e IT, të udhëhequr nga kompania INFIGO.

Nën dritën e fokusit në rritje që Banka e Shqipërisë ka në çështjen e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit gjatë inspektimeve në banka, Komiteti organizoi në Tetor një takim ku u diskutua gjerësisht dhe u shkëmbyen eksperiencat në lidhje me këtë çështje, ndihmuar edhe nga një prezantim shumë praktik nga Raiffeisen Bank. Një tjetër çështje e diskutuar në këtë takim ishte ajo mbi Kriptografinë, prezantuar nga Veneto Banka.

## vii. KOMITETI LIGJOR

Komiteti Ligjor i AAB-së, si një organ i rëndësishëm këshillimor i Shoqatës, gjatë këtij viti ka trajtuar një numër të konsiderueshëm çështjesh, si lidhur me projekte ligjesh dhe aktesh nënligjore të paraqitura nga autoritete të tilla si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, dhe Banka e Shqipërisë, ashtu edhe me çështje lidhur me problematika dhe vështirësi të zbatimit të akteve ligjore tashmë të miratuara.

Një nga çështjet më të rëndësishme për të cilën AAB dhe Komiteti Ligjor kanë lobuar dhe punuar në vitet e fundit ka qenë ndryshimi i Kodit të Procedurës Civile. Në Janar 2013, Ministria e Drejtësisë mori më në fund parasysh propozimet e paraqitura nga AAB. Miratimi i ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile nga Parlamenti në muajin Prill 2013, ishte një nga arritjet më të rëndësishme të Komitetit Ligjor, sidomos duke pasur parasysh se shumica e komenteve dhe sugjerimeve të AAB-së lidhur me procedurat e ekzekutimit të titujve janë marrë në konsideratë në ndryshimet e miratuara.

Gjatë vitit Komiteti Ligjor gjithashtu ka diskutuar dhe adresuar tek autoritetet kompetente çështje të tjera operationale dhe rregullatore, të tilla si: vështirësitë dhe pasiguritë për zbatimin e Ligjit të ri “Për Sistemin e Pagesave”, si dhe nevojën për të bërë korrigjime në Ligjin e ndryshuar së fundmi “Për barrët siguroese”; nevojën për të bërë ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë mbi metodën e pagesës së tarifave të shërbimit përmbartimor privat dhe kontratën-tip të Ministrit të Drejtësisë për këtë qëllim; kërkesën për ndryshime në Udhëzimin e Bankës së Shqipërisë “Për ekzekutimin e detyrimeve mbi shumat e llogarive në bankë”, duke u fokusuar tek problemet ligjore dhe operative në lidhje me zbatimin e tij.

## **viii. KOMITETI I SISTEMEVE TË PAGESAVE**

Gjatë vitit 2013, Komiteti diskutoi për çështje operacionale në lidhje me sistemet e pagesave, si me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe me ekspertë të tjerë të huaj. Në fillim të vitit Komiteti diskutoi dhe kontribuoi me komente mbi draftin “Metodologjia e raportimit të instrumenteve të pagesave”, të paraqitur nga Departamenti i Pagesave në Bankën e Shqipërisë.

Sekretariati i AAB-së organizoi në një takim të Komitetit të Sistemeve të Pagesave me përfaqësues të Aleancës Evropiane të SWIFT (ESA) për të diskutuar mbi zhvillimet e fundit dhe inovacionet në shërbimet dhe produktet e SWIFT, si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së bankave në rrjetin ESA.

Një tjetër takim interesant ishte ai i Komitetit të Sistemeve të Pagesave me përfaqësues të kompanisë SIA, një kompani teknologjike e krijuar nga Banka e Italisë dhe Shoqata Italiane Bankave, që prezantoi shërbimet që kompania ofron për përmirësimin e infrastrukturës së sistemeve të pagesave, si dhe diskutoi me anëtarët e Komitetit potencialin për këto shërbime në Shqipëri.

## II. TAKIME TË TJERA TEKNIKE

AAB kontribuoi në përmirësimin e komunikimit të bankave anëtare me Autoritetin Mbikëqyrës dhe autoritete të tjera shtetërore nëpërmjet organizimit të takimeve dhe forumeve për diskutime dhe konsultime. Gjatë vitit, **AAB organizoi 33 takime dhe 2 seminare të përfaqësuesve të bankave me autoritete** të tilla si Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Drejtorja e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë e Tiranës, Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ekspertë të Bankës Botërore, etj..

### I. AAB - BANKA E SHQIPËRISË

Takimet e organizuara me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë:

**Grupi i punës për BASEL II** – Grupi i punës i krijuar nga AAB dhe BSh me përfaqësues nga disa banka anëtare u mbledh sipas një programi të paracaktuar përgjatë shtatë javëve në Prill dhe Maj, çdo të enjte dhe të premte, në ambientet e AAB-së, për të diskutuar mbi projekt rregullore “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”. Pas përfundimit të takimeve të rregullta në fund të Majit 2013, AAB organizoi një takim të fundit vetëm me përfaqësuesit e bankave, ku ata finalizuan sugjerimet e tyre për ndryshime në projekt rregullore, të cilat u dërguan zyrtarisht nga AAB për BSh-në, duke theksuar nevojën për shtyrjen me të paktën një vit të afatit të hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Rregullorja u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë më 30 Korrik 2013 dhe do të hyjë në fuqi në 31 Dhjetor 2014.

Grupi i punës vijoi të mbledhet që prej Tetorit 2013, për të diskutuar mbi tabelat e raportimit sipas rregullores së re. Në këto takime u diskutuan shembuj praktikë për tabelat e raportimit mbi rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut, rrezikun operacional dhe titullzimet.

**Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë** – Bankat dhe BSh diskutuan, gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, si në nivel të lartë drejtues ashtu edhe në nivel më teknik, mbi paketën e propozuar të masave me qëllim nxitjen e kreditimit. Anëtarët e Bordit Drejtues të AAB-së dhe përfaqësuesit teknikë të bankave shprehën opinionet dhe argumentet e bankave, me gojë dhe me shkrim, lidhur me masat e propozuara, si dhe propozuan të tjera masa. Kundërshtimi kryesor i bankave ishte në lidhje me rritjen e koeficientit të riskut për ponderimin e investimeve të bankave jashtë vendit, si një masë që pritet të ketë fare pak ose asnjë efekt në rritjen e kreditimit. Propozimet e mëtejshme nga AAB ishin: marrja në konsideratë e vlerës së kolateralit fizik për qëllime të provigjionimit të kredisë; liberalizimi i kreditimit të qeverisë shqiptare në monedhë të huaj; dhe një kuadër rregullator më i plotë e më stimulues për shitjen e portofoleve të kredive me probleme.

**Rregullore të reja për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave** – Në Qershor dhe Gusht, AAB organizoi dy takime me ekspertë nga Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për të diskutuar mbi rregulloret e reja të hartuara dhe miratuara nga BSh mbi trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave (*më shumë detaje në seksionin “Rregulloret e Bankës e Shqipërisë”*). Përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë prezantuan Zyrën e re të

Qendrës Kombëtare për Analiza e krijuar për zbatimin e kuadrit rregullator për kontrollin e autenticitetit të kartëmonedhave. Qendra do të ketë një rol të rëndësishëm në luftën për zbulimin, parandalimin dhe mbrojtjen nga kartëmonedhat e falsifikuara. Shumica e komenteve të bëra nga bankat mbi projekt-rregulloret u morën në konsideratë në rregulloret përfundimtare të miratuara, dhe bankave anëtare iu mundësua në këto takime një pamje më e qartë mbi procedurat e parashikuara në këto rregullore.

**Metodologjia e re e raportimit të Bankës së Shqipërisë** – AAB organizoi në Maj një takim me Drejtorët dhe përfaqësues të departamenteve të financave të të gjithë bankave anëtare për t'i informuar lidhur me projektin e BSh-së për ndryshimin e metodologjisë së raportimit të saj drejt përputhshmërisë me SNRF, projekt ky i bashkëfinancuar nga AAB dhe FSVC. Pjesëmarrësit diskutuan mbi projektin e parë të përgatitur nga Deloitte (firma konsulente e zgjedhur për të hartuar metodologjinë e re), i cili u testua në vijim me dy banka. Banka e Shqipërisë pritet të finalizojë projekt metodologjinë dhe ta sjellë atë për diskutim me bankat përpara miratimit final.

## ii. AAB - QEVERIA

Anëtarët e AAB-së u takuan në Korrik 2013 me Kryeministrin e sapozgjedhur, Z. Edi Rama, Guvernatorin dhe përfaqësues të tjerë të lartë të Bankës së Shqipërisë e Qeverisë, në një takim të organizuar nga AAB në Hotel Sheraton Tirana. Bankat evidentuan një listë të reformave të nevojshme dhe çështje specifike ligjore që ndikojnë në mirëfunksionimin e sektorit bankar në Shqipëri. Sekretariati i AAB-së përgatiti në vijim një shkresë zyrtare me çështjet e ngritura që iu dërgua kabinetit të Kryeministrit si edhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë.



### iii. AAB - BANKA BOTËRORE

AAB organizoi një takim në Janar, ku ekspertë nga Banka Botërore informuan bankat mbi projektin për Përmirësimin e Raportimit Financiar të Bizneseve të administruar nga Qendra e Bankës Botërore për Reforma në Raportimin Financiar dhe të financuar nga programi REPARIS. Ky projekt ka për qëllim të përmirësojë kuadrin për raportimin financiar të bizneseve në Shqipëri duke ndihmuar në hartimin dhe zbatimin e reformave në kuadrin ligjor të Shqipërisë për kontabilitetin dhe auditimin. Qëllimi kryesor i takimit ishte përfshirja e bankave në këtë projekt, si përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare. Bankat pjesëmarrëse diskutuan mbi cilësinë e pasqyrave financiare të paraqitura nga klientët që kërkojnë financim.

Kryetari dhe Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së janë takuar rregullisht gjatë vitit me ekspertë të Bankës Botërore me misione në Tiranë për vlerësimin e gjendjes dhe zhvillimeve të mundshme në sektorin financiar, në dritën e zhvillimit të përgatitjeve për një marrëveshje të re me Qeverinë shqiptare, në formën e një huaje për Politikën e Zhvillimit për Modernizimin e Sektorit Financiar. Ata kanë përcjellë në këto takime shqetësimet dhe problematikat në sektorin bankar shqiptar.

### iv. AAB - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE (DPPPP)

AAB organizoi dy tryeza të rumbullakëta me të gjithë anëtarët e Komitetit të saj të Përputhshmërisë, përfaqësues të DPPPP-së, si dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, në Maj dhe Shtator 2013. Këto tryeza kishin për qëllim përmirësimin e raportimit nga bankat në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe rritjen e raportimit të transaksioneve të dyshimta, si edhe rritjen e cilësisë dhe analizimit të këtyre raportimeve. Në të dy takimet, pjesëmarrësit sollën raste praktike dhe diskutuan për probleme të veçanta teknike të hasura gjatë raportimit të bankave dhe për mënyrat më të mira për t'i zgjidhur ato në të ardhmen.





## **v. AAB - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA E TIRANËS**

Sekretariati i AAB-së organizoi një takim të Komitetit të Përputhshmërisë me përfaqësuesit dhe Drejtoreshën e Përgjithshme të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë e Tiranës, për të diskutuar mbi zgjidhjet e mundshme për të lehtësuar dhe përshpejtuar komunikimin ndërmjet kësaj Drejtorie dhe bankave tregtare. Palët ranë dakord në lehtësimin e procesit përmes shkëmbimit elektronik të informacionit dhe të urdhrave të bllokimit të llogarive bankare për detyrimet e tatimpaguesve, duke pasur parasysh problemet me sistemin e adresave, dhe ngarkesën për bankat nga hedhja manuale e të dhënave. U ra dakord edhe për formatin përkatës elektronik për dërgimin e informacionit, dhe përfaqësuesit e Bashkisë u angazhuan për të plotësuar në mënyrë më të saktë informacionin për debitorët individë dhe subjekte.

## **vi. AAB - ZYRA E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

AAB organizoi në Prill 2013 një takim me Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të diskutuar mbi problemet me të cilat janë përballuar bankat në lidhje me zbatimin e projektit FATCA, dhe për marrjen e një interpretimi zyrtar në lidhje me detyrimet dhe kufizimet e bankave në Shqipëri për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave siç kërkohet nga ky projekt.



### III. EDUKIMI FINANCIAR

AAB është e angazhuar në zhvillimin e projekteve të përshtatshme në edukimin financiar. Është shumë e rëndësishme që individët, duke filluar që në moshë të vogël, të marrin informacion të mjaftueshëm dhe të trajtohen mbi elementët bazë të kulturës financiare, në mënyrë që të mund të marrin vendime më kompetente sipas nevojave dhe objektivave të tyre gjatë gjithë jetës. Në këtë drejtim, AAB ka ndërmarrë disa aktivitete me fokus fëmijët dhe të rinjtë.

**Mars 2013** – AAB dhe Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, organizuan një aktivitet me temë **“Rëndësia e Edukimit Financiar”**, në ambientet e Shkollës së Mesme Ekonomike në Tiranë, në kuadër të **“Java Globale e Parasë”**. Kjo është një festë mbarë botërore e parasë, që synon ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të ardhshëm të përgjegjshëm dhe të aftë financiarisht, në të cilën këtë vit u angazhua edhe Shoqata e Bankave.

**Maj 2013** – AAB në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, përgatitën një broshurë mbi Kartat e Kreditit dhe përdorimin e tyre duke përfshirë informacion mbi kartat bankare, normat e interesit lidhur me to, standardet e transparencës, si edhe këshilla mbi përdorimin e duhur të kartave në blerjet në internet. Broshura u shpërnda në Forumin Kombëtar të Kartave, u publikua në faqen e internetit të AAB-së dhe numrin e radhës të revistës Bankieri, si dhe u shpërnda fizikisht në degët kryesore të bankave anëtare.

**Qershor 2013** – Në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet AAB-së dhe Universitetit Europian të Tiranës (UET) dhe të fushatës së AAB-së për Edukimin Financiar, Zj. Endrita Xhaferaj, Sekretare e Përgjithshme e AAB-së dhe Zj. Najada Xhaxha (Tirana Bank), Kryetare e Komitetit të AAB-së për Sistemet e Pagesave, zhvilluan dy seminare të hapura mbi bankingun për studentët, si pjesë e programit të diplomimit në drejtimin Bankë dhe Financë. Në vazhdim, nga 24 Qershor deri më 1 Korrik, AAB organizoi vizita të këtyre studentëve në disa prej degëve të bankave në Tiranë, si pjesë e mësimit të tyre praktik. Bankat që mirëpritën studentët ishin: Alpha Bank Shqipëri, BKT, Credins Bank, Fibank Shqipëri, Intesa SanPaolo Bank, NBG Bank Shqipëri dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

**Nëntor 2013** – AAB në kuadër të angazhimit të saj për edukimin financiar, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, bëri të mundur printimin dhe shpërndarjen falas për vitin akademik 2013-2014 të rreth 2500 kopjeve të paketës së re mësimore në edukimin financiar **“1,2, 3... Derrkuci Çufo mëson të kursejë”**, për nxënësit e klasave të I, II, dhe III të shkollave fillore. Sekretariati i AAB-së u angazhua për shpërndarjen e këtyre paketave në 9 shkolla të Tiranës si dhe për prezantimin e tyre në shkollën fillore “Fan S. Noli” në Tiranë.



## IV. TRAJNIME DHE SEMINARE

Sekretariati i AAB-së në bashkëpunim dhe me mbështetjen e **13 partnerëve për trajnime**, organizoi gjatë vitit 2013 20 kurse trajnime për rreth 200 punonjës të bankave anëtare. Bashkëpunimi me BACEE pati sukses edhe këtë vit falë trajnerëve të mirënjohur Dr. Paul Gauci dhe anëtarit të Komisionit të Bankingut në ICC, Z. Pavel Andrle. Partneritetet e reja me Institutin e Inxhinierisë Financiare për Bankë dhe Sigurime dhe Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm ishin shumë të dobishme për AAB-në në përmbushjen e qëllimit të saj për të përmirësuar cilësinë e trajnimeve, si vendase ashtu edhe ndërkombëtare. Partnerët të tjerë të rëndësishëm ishin Deloitte Albania, FSCV, Partners Albania, etj..

### **Kurs trajnimi mbi “Menaxhimin e rrezikut të kredisë”**

**20-22 Shkurt 2013** – Në bashkëpunim me Institutin e Inxhinierisë Financiare të Bankave dhe Sigurimeve, AAB organizoi një kurs trajnimi tre ditor mbi “Menaxhimin e rrezikut të kredisë”, për tu ofruar pjesëmarrësve një pasqyrë të plotë të administrimit të suksesshëm të rrezikut të kredisë duke përdorur mënyrat më bashkëkohore të identifikimit, matjes, kontrollit dhe shmangies së këtij rreziku. Trajnimi u drejtua nga Z. Ilir Hoti dhe u ndoq nga 12 përfaqësues të departamenteve të rrezikut të kredisë nga 7 banka anëtare.

### **Kurs trajnimi mbi “Kujdesi ndaj Klientit, Aftësitë e Shitjes dhe Negocimit”**

**26-27 Shkurt 2013** – Kursi dy ditor i udhëhequr nga Z. Paul Gauci u fokusua në çështjet dhe praktikat më të mira që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj klientëve, aftësitë dhe artin e shitjes dhe negocimit, dhe u ndoq nga 14 pjesëmarrës nga 6 banka anëtare.

### **Kurs trajnimi mbi “Praktikat më të mira të Drejtimit”**

**28 Shkurt-1 Mars 2013** – Në programin e trajnimit dy-ditor për menaxherët dhe udhëheqësit e ekipeve, të drejtuar nga Z. Paul Gauci morën pjesë 14 punonjës nga 6 banka anëtare. Qëllimi kryesor i kursit ishte rritja e aftësive të drejtimit, komunikimit, motivimit dhe të ndërtimit të ekipeve, për të bërë të mundur rritjen e efikasitetit dhe rezultateve të punës në grup.

### **Kurs trajnimi mbi “Menaxhimin e Vazhdimësisë së Biznesit”**

**6-7 Mars 2013** – Kursi i trajnimit të zhvilluar nga Deloitte përfshinte një pamje të përgjithshme mbi programet dhe hapat për tu ndjekur për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit duke adresuar çështje lidhur me: krijimin e planeve dhe dokumentimin e tyre; Analizën e Ndikimit në Biznes (BIA); mundësitë dhe strategjitë e rikuperimit; trajnimin dhe ndërgjegjësimin; dhe mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve në këtë drejtim.

### **Seminar mbi rekomandimet e FATF dhe trajnimi i subjekteve raportuese**

**6-7 Mars 2013** – Sekretariati i AAB-së bashkëpunoi me Projektin e Binjakëzimit “Mbështetje për luftën kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimit financiar në Shqipëri” në Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar pjesëmarrjen e 26 përfaqësuesve nga 16 banka anëtare në seminarin mbi rekomandimet e FATF për subjektet raportuese, të organizuar në ambientet e Prokurorisë së Përgjithshme.

### Kurs trajnimi “Trajno Trajnues”

**27-28 Mars 2013** – AAB, në bashkëpunim me Partners Albania, organizoi një kurs për trajnimin e trajnuesve në banka. Programi mbuloi në disa seanca tema të tilla si: parimet e të nxënit; planifikimin dhe organizimi i trajnimit; dhe menaxhimi dhe mësimdhënia në trajnim.

### Seminar për “Përmirësimin e lidhjeve elektronike mes përfituesve”

**5 Prill 2013** – AAB mundësoi pjesëmarrjen e oficerëve IT në banka në seminarin e organizuar nga Prokuroria e Përgjithshme në kuadër të projektit të binjakëzimit për “Mbështetje për luftën kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimit financiar në Shqipëri”. Ky aktivitet u drejtua nga ekspertë të Komunitetit Europian dhe u fokusua në praktikat më të mira të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente shqiptare.

### Trajnim mbi “Affësitë prezantuese në gjuhën Angleze”

15 Prill 2013 – AAB organizoi një kurs një ditor mbi prezantimin në mënyrë efektive dhe me besim në gjuhën Angleze, për dhënien e njohurive të nevojshme për të folur me besim përpara një audience. Ky trajnim ndërveprues u drejtua nga Z. Andy Zdan-Michajłowicz.

### Kurs trajnimi për “Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit”

**14-16 Maj 2013** – AAB organizoi një trajnim tre-ditor për Menaxhimin e Informacionit të Sigurisë, programi i të cilit ishte zhvilluar në mënyrë të posaçme për të informuar pjesëmarrësit mbi konceptet themelore të sigurisë, proceset cilësore dhe sasiore të menaxhimit të rreziqeve, etj..

### Trajnim mbi “Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme”

**22-23 Maj 2013** – AAB në bashkëpunim me Deloitte organizoi një kurs dy ditor për vlerësimin e pasurive të paluajtshme. Trajnimi, ku morën pjesë 15 persona nga 6 banka, kishte për qëllim tu ofronte pjesëmarrësve njohuri fillestare për kërkesën për një vlerësim si edhe mbi leximin dhe rishikimin sa më efikas të raportit të vlerësimit.

### Seminar mbi Programin e Energjisë së Rinovueshme

**28 Maj 2013** – IFC dhe AAB organizuan një seminar për bankat tregtare në vend si pjesë e një më programi më të gjerë të IFC për Energjinë e Rinovueshme në Ballkan. Objektivi kryesor ishte prezantimi për bankat i mundësive për investime në projektet e energjisë të rinovueshme në Shqipëri, si dhe rreziqet më karakteristike lidhur me projekte të tilla.

### Trajnim mbi “Bazel III në lidhje me likuiditetin”

**13 Qershor 2013** – AAB në bashkëpunim me Programin e FSVC-së organizuan një trajnim të prezantuar nga dy ekspertë të Bankës Qendrore të Danimarkës. Disa nga temat e mbuluara në trajnim ishin: qëllimi i Kuadrit Përkufizues mbi Likuiditetin në Bazel III dhe i raportit të mbulimit të likuiditetit; zbatimi i Basel III në BE; përvoja daneze me Bazel III; etj..

### Trajnim mbi “Zbatimin e Bazel II në Shqipëri”

**21 Qershor 2013** – Ernst & Young organizoi një seminar një ditor për Bankën e Shqipërisë lidhur me zbatimin e Bazel II në Shqipëri. AAB mundësoi pjesëmarrjen në këtë seminar 20 përfaqësuesve nga bankat.

### Seminar mbi “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në banka”

**20 Shtator 2013** – AAB në bashkëpunim me Programin e FSVC-së organizoi një seminar mbi SNK / SNRF në banka, i drejtuar nga Z. Mathew Macellaro dhe Zj. Rita Ilisson që folën për rregullat e kontabilitetit në lidhje me administrimin e rrezikut të kredisë; SNRF-të përkundrejt Bazel II në lidhje me provigjionimin e kredive; qiranë financiare dhe Faktoringun; si dhe aktivet në ekzekutim dhe me probleme.

### Trajnim mbi bankingun privat

**4 Tetor 2013** – AAB në bashkëpunim me Universitetin Luarasi organizuan një seminar një ditor mbi bankingun privat i cili u drejtua nga Profesor Roberto Ruozzi, ish rektor i Universitetit Bocconi, dhe ekspertë të tjerë të sektorit financiar.

### Trajnim mbi “Operacionet e Financimit të Tregtisë”

**7-9 Tetor 2013** – Trajnimi tre-ditor i drejtuar nga Z. Pavel Andrle, Sekretar i Komisionit të Bankingut të ICC Republika Çeke, i organizuar për herë të dytë në 2 vjet, ishte projektuar posaçërisht për të adresuar situatën aktuale në ekonominë globale dhe zhvendosjen drejt mjeteve tradicionale të pagesave si instrumentet më të sigurta të pagesave ndërkohë që rreziqet e pagesave dhe pasiguria vjen duke u rritur.

### Trajnim mbi “Garancitë dhe llogaritë e arkëtueshme”

**10-11 Tetor 2013** – Trajnimi dy-ditor i drejtuar nga Z. Andrle u fokusua në përdorimin praktik të rregullave të reja, si dhe çështjet kryesore dhe ndryshimet lidhur me teknikat e ndryshme të financimit të llogarive të arkëtueshme të tilla si faktoringu.

### Trajnim mbi “Standardet e Sigurisë në Industrinë e Pagesave me Kartë (PCI DSS)”

**24-25 Tetor 2013** – Trajnimi u zhvillua nga Dr Abiola Abimbola Ph.D., një Vlerësues i Certifikuar i Sigurisë sipas PCI DSS, me shumë vite eksperiencë në industrinë e përputhshmërisë me standardet e sigurisë së informacionit. Ai pati për qëllim ofrimin e njohurive më të thelluara në fushën e zbatimit të PCI DSS.

### Trajnim “Auditimi i funksionit të thesarit - udhëzues për një praktikues”

**11-12 Nëntor 2013** – AAB në bashkëpunim me AIIA organizuan një trajnim praktik mbi profesionin e auditimit në banka që ofroi një perspektivë më të qartë e konstruktive mbi auditimin e funksionit të thesarit. Përfaqësues të 9 bankave morën pjesë në trajnim.

### Seminar mbi “Ndërgjegjësimi mbi sigurinë bankare”

**20 Nëntor 2013** – Sekretariati i AAB-së, mbështetur nga Komiteti i AAB-së për Sigurinë bankare dhe Intesa SanPaolo Bank, organizoi një seminar drejtuar punonjësve të sigurisë së bankave, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë bankare. Seminari u ndoq nga punonjësit e sigurisë 16 bankave.

## V. PJESËMARRJE DHE AKTIVITETE SOCIALE TË AAB-së

**Takimi i 36-të dhe 37-të i Anëtarëve të Asociuar të EBF-së** - AAB mori pjesë në Takimin e 36-të anëtarëve të asociuar të Federatës Bankare Evropiane mbajtur në Qershor në Shkup, Maqedoni, përfaqësuar nga Specialistja e Operacioneve, Znj. Junida Katroshi Tafaj, si dhe takimin e 37-të të organizuar në Bruksel, Belgjikë në Dhjetor, përfaqësuar nga Sekretarja e Përgjithshme.

**Panairi Financiar 2013 në Prishtinë, Kosovë** - Sekretarja e Përgjithshme dhe Specialistja e Operacioneve të AAB-së morën pjesë në Panairin Financiar 2013 të organizuar në Shtator nga Shoqata e Bankave të Kosovës, në Prishtinë. Ky panair është një nga ngjarjet më të rëndësishme ekonomike në Kosovë që sjell së bashku specialistë nga sektori financiar, institucionet financiare ndërkombëtare, bizneset lokale dhe ndërkombëtare, shoqatat dhe grupet e biznesit, si dhe personalitete nga skena ekonomike dhe shoqëria civile, për të diskutuar mbi sektorin financiar në Kosovë.

**Takime me Delegacionin e BE-së në Shqipëri** - Kryetari i AAB-së, Z. Pencabligil, dhe Zëvendës Kryetari, Z. Kougionas, morën pjesë në takimin konsultativ të organizuar në Prill nga Delegacioni i BE-së me përfaqësues të bizneseve lokale dhe të huaja, në kuadër të përgatitjeve për hartimin e Raportit Vjetor të Progresit 2013 për Shqipërinë, ku ata evidentuan shqetësimet dhe çështjet me interes për sektorin bankar.

Disa nga Drejtorët e bankave dhe Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së morën pjesë në takimin me Ambasadorin e Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Z. Ettore Sequi që u organizua në vijim, në Tetor 2013, ku u prezantua Raporti i Progresit Shqipëri 2013.

**Tryezë e rrumbullakët mbi "Rishikimin e procesit të përkthimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar në shqip"** - AAB mbështeti Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit për të organizuar një tryezë të rrumbullakët në Nëntor, mbi procesin e përkthimit në shqip të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Sekretarja e Përgjithshme e AAB-së dhe përfaqësues nga 7 banka morën pjesë në këtë tryezë dhe u angazhuan të marrin pjesë edhe në procesin në vijim për përkthimin dhe rishikimin të SNRF-ve në të ardhmen.

### **Pritje Lamtumire**

Gjatë vitit 2013, AAB organizoi pritje lamtumire në nder të dy ish Drejtorëve që u larguan nga bankat e tyre dhe nga Shqipëria dhe në shenjë mirëseardhjeje për Drejtuesit e rinj.

- **20 Gusht 2013** - me rastin e largimit të Z. Hubert de Saint Jean nga pozicioni i tij si Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale Shqipëri, AAB organizoi një pritje ku i uroi mirëseardhjen edhe Z. Frederic Blanc si Drejtori i ri i bankës dhe anëtar i Shoqatës.
- **27 Shtator 2013** - AAB organizoi një pritje në nder të Z. Alexander Resch, i cili u largua nga pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Intesa SanPaolo Bank Shqipëri dhe për ti uruar mirëseardhjen në Shoqatë Drejtorit të ri, Z. Silvio Peddrizzi.

### **Vizitë nga Shoqata e Bankave të Kosovës**

Përfaqësuesit e Shoqatës së Bankave të Kosovës vizituan Shoqatën Shqiptare të Bankave në Gusht, në një takim të parë zyrtar mes dy shoqatave, si një pikënisje për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet dy institucioneve.



## DARKA E VITIT TË RI

AAB organizoi në Dhjetor darkën vjetore Gala me rastin e festave të fund vitit. Drejtorët dhe përfaqësues të tjerë të bankave anëtare, Guvernatori Z. Ardian Fullani, të ftuar të tjerë nga Banka e Shqipërisë, si dhe anëtarët e Bordit Editorial të Revistës Bankieri morën pjesë në këtë event. Të ftuar nderi në të ishin Ambasadori i Delegacionit të BE-së në Shqipëri Z. Ettore Sequi si dhe Z. Nadeem Ilahi, Shef i Misionit të FMN-së në Shqipëri.



# BANKAT ANËTARE – FAKTE DHE SHIFRA

TË DHËNAT E AUDITUARA SIPAS IFRS, NË 31.12.2013, NË MIJË EUR (1 EUR = 140.2 ALL)

Banka	Struktura e Aksionarëve:	Vendi i origjinës	Aktivët	Kreditë	Kapitalet e veta	Depozita
 <b>ALPHA BANK</b>	Alpha Bank AE (100%)	Greqi	583,563	247,568	82,404	480,992
 <b>BKT</b> BANKA KOMBETARE TREGTARE	Calik Finansal Hizmetler A.S. (100%)	Turqi	1,944,016	643,856	156,180	1,565,146
 <b>CREDINS bank</b>	Individë dhe Unioni SHKK (78%)	Shqipëri	767,526	480,288	69,956	654,752
	B.F.S.E. Holding BV (19.25%)	Hollandë				
	SIFEM AG (2.75%)	Zvicër				
 <b>CBA</b> CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE	Al-Kharafi Group (100%)	Kuvajti	1,308	1,851	7,233	3,659
 <b>CRÉDIT AGRICOLE</b>	IUB Holding (100%)	Francë	217,622	151,705	31,469	135,704
 <b>Fibank</b> First Investment Bank	Fibank AD (100%)	Bullgari	121,707	46,423	10,059	109,890
 <b>Banka Ndërkombëtare Tregtare International Commercial Bank</b>	Financial Group Holding A.G.	Zvicër	65,544	20,275	11,202	48,649
 <b>INTESA SANPAOLO BANK</b> Albania	Intesa Sanpaolo S.p.A. (98.61%)	Itali	992,793	363,139	128,384	818,123
	Società Italiana per le Imprese all'Estero S.p.A. (1.39%)					
 <b>NBG Bank</b>	NBG Group S.A. (100%)	Greqi	316,184	204,029	57,449	245,429
 <b>ProCredit Bank</b>	Procredit Holding (100%)	Gjermani	287,874	163,979	33,479	231,399
 <b>Raiffeisen BANK</b>	Raiffeisen SEE Region Holding GmbH (100%)	Austri	2,072,507	912,961	212,714	1,757,385
 <b>SOCIETE GENERALE ALBANIA</b>	Societe Generale (88.64%)	Francë	499,256	268,336	56,169	404,343
	Aksionarë të tjerë (11.36%)	Shqipëri				
 <b>TIRANA BANK</b>	Piraeus Bank (98.83%)	Greqi	724,538	313,804	133,792	560,847
	Tzivelis Ioannis Greece (1.17%)					
 <b>UNION BANK</b>	Unioni Financiar Tirane (UFT) Sh.p.k (85.66%)	Shqipëri	233,072	101,614	18,050	194,265
	European Bank for Reconstruction and Development (EBRD) (10.62%)	Mbretëria e Bashkuar				
	Edmond Leka (1.86%)	Shqipëri				
	Niko Leka (1.86%)					
 <b>UBA</b> United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqipërisë	Islamic Development Bank (86.70%)	Arabia Saudite	44,249	10,626	10,302	33,725
	Ithmaar Bank (4.63%)	Bahrejn				
	DaLah Albaraka Holding Co. (2.32%)	Malajzi				
	Business Focus SDN BHD (1.47%)	Arabia Saudite				
	Saudi Brother Commercial Co. (0.58%)					
	Individë (4.31%)					
 <b>VENETO BANKA</b> GRUPPO VENETO BANCA	Veneto Banca S.p.A. (100%)	Itali	160,488	99,976	32,831	121,038

Fitimi neto	Nr. Dëgjës	Nr. Punonjësish	Nr. ATM	Nr. i kartave të leshuara	Karta Debiti	Karta Krediti	Nr. POS	Internet Banking	M-Banking	E-commerce
(103)	42	395	58	52,147	46,499	5,648	1,194	Po	Jo	Jo
28,555	84	1,161	132	214,753	187,601	27,152	2,936	Po	Po	Po
1,925	47	619	56	62,082	59,479	2,603	34	Po	Jo	Po
(813)	2	29	0	0	0	0	0	Jo	Jo	Jo
(3,071)	20	259	36	18,983	18,021	962	0	Po	Jo	Jo
844	9	122	28	27,517	24,989	2,528	0	Po	Jo	Jo
340	7	85	7	3,619	3,619	0	0	Jo	Po	Jo
7,003	31	533	55	68,994	68,994	N/A	616	Po	Jo	Jo
602	27	265	35	30,421	29,760	661	0	Jo	Jo	Jo
(1,193)	30	452	62	48,157	46,938	1,219	434	Po	Jo	Jo
31,813	102	1,417	195	234,083	208,891	25,192	1,423	Po	Po	Po
2,909	42	399	63	22,332	22,332	0	0	Po	Po	Jo
(10,865)	53	466	83	83,918	79,831	4,087	271	Po	Po	Jo
491	29	306	40	34,732	33,383	1,349	0	Po	Po	Jo
(434)	6	75	0	0	0	0	0	Jo	Jo	Jo
540	15	126	16	5,988	5,797	191	0	Po	Po	Jo

# PASOYRAT FINANCIARE TË AAB-së

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2013



# Përmbajtja



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	38
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE.....	39
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE.....	40
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	41

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2013

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<b>Aktivet</b>			
Arka dhe banka	4	7,042,838	7,647,176
Shpenzime të parapaguara	5	698,843	574,421
Llogari të arkëtueshme	6	302,554	293,250
<b>Totali i Aktiveve Afatshkurtra</b>		<b>8,044,234</b>	<b>8,514,846</b>
Aktivet Afatgjata			
Aktivet e qëndrueshme, neto	7	854,513	1,022,823
<b>Totali i Aktiveve Afatgjata</b>		<b>854,513</b>	<b>1,022,823</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>8,898,747</b>	<b>9,537,669</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime ndaj Bankave	8	-	-
Llogari të pagueshme	9	432,425	796,859
<b>Totali i Detyrimeve Afatshkurtra</b>		<b>432,425</b>	<b>796,859</b>
<b>Aktivet Neto</b>		<b>8,466,322</b>	<b>8,740,810</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>8,898,747</b>	<b>9,537,669</b>

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE MË 31 DHJETOR 2013

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<b>Të ardhurat</b>	10		
Kuotat e anëtarësisë		33,001,000	33,001,000
Të ardhura të tjera		6,576,113	7,636,431
<b>Totali i të Ardhurave</b>		<b>39,577,113</b>	<b>40,637,431</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Amortizimi	7	(249,130)	(234,363)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrimit	11	(39,563,458)	(40,859,450)
Humbje nga këmbimet	12	(39,013)	(27,982)
<b>Totali i Shpenzimeve</b>		<b>(39,851,601)</b>	<b>(41,121,795)</b>
<b>Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve</b>		<b>(274,488)</b>	<b>(484,364)</b>
Aktivet Neto në fillim të vitit		8,740,810	9,225,174
<b>Aktivet Neto në fund të vitit</b>		<b>8,466,322</b>	<b>8,740,810</b>

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

## PASQYRA E RRJEDHËS SË PARAVE MË 31 DHJETOR 2013

Në LEK	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>			
Teprica/(Deficiti) i të Ardhurave ndaj Shpenzimeve		(274,488)	(484,364)
Rregullime për :			
Amortizimin	7	249,130	234,363
<b>Fluksi monetar nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		<b>(25,298)</b>	<b>(250,001)</b>
<i>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare dhe investuese</i>			
Pagesa për shpenzimet e parapaguara	5	(124,422)	(23,511)
Llogari të arkëtueshme	6	(9,304)	(293,250)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	7	(80,820)	(295,600)
Arkëtime nga bankat për detyrime afatshkurtra	8	-	(16,097)
Pagesa për llogaritë e pagueshme	9	(364,493)	485,398
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare dhe investuese</b>		<b>(579,039)</b>	<b>(143,060)</b>
<b>Rritja/(Rënia) neto e mjeteve monetare</b>		<b>(604,338)</b>	<b>(393,061)</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	4	7,647,176	8,040,236
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</b>	4	<b>7,042,838</b>	<b>7,647,176</b>

Pasqyra e rrjedhës së Parave duhet të lexohet së bashku me shënimet përkatëse, pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat Financiare të Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) janë përpiluar dhe nxjerrë në datë 21.03.2014 dhe nënshkruar nga:



**Endrita XHAFERAJ**  
Sekretare e Përgjithshme  
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



**Lindita ELEZI**  
Drejtor, Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit  
BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE



## SHËNIME MBI PASOYRAT FINANCIARE

### 1. Informacion i Përgjithshëm

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është themeluar më 15 Prill 1999 me seli në adresën: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla I, Kati 6 A. 3, Tiranë, Shqipëri.

Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) është një shoqatë jo fitimprurëse, e cila përpiqet të promovojë standardet më të fundit Bankare të anëtarëve të saj, zhvillimin, stabilitetin dhe efektshmërinë e sistemit bankar shqiptar në përgjithësi, duke kontribuar kështu në përparimin e ekonomisë shqiptare. AAB përbëhet nga 16 anëtarë, mbi baza vullnetare: Alpha Bank Albania, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Societe General Albania, Banka Credins, Banka e Kreditit të Shqipërisë, Credit Agricole, Fibank Shqipëri, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka Intesa SanPaolo Albania, Veneto Banka, NBG Bank Albania, Banka ProCredit, Raiffesien Bank Albania, Banka e Tiranës, Banka Union, Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

### 2. Baza e Përgatitjes

Librat dhe regjistrimet kontabël të AAB mbahen sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

### 3. Përmbledhje e Politikave Kontabël

#### 3.1 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat regjistrohen kur realizohen dhe shpenzimet kur ndodhin.

#### 3.2 Aktivët e Qëndrueshme

Aktivët e qëndrueshme mbahen me kosto, minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi kryhet sipas metodës së vlerës së mbetur, duke shpërndarë koston e pasurisë dhe pajisjeve, përgjatë gjithë periudhës së pritshme të përdorimit të tyre. Amortizimi fillon të regjistrohet që nga muaji pasardhës i atij të blerjes, me normat respektive prej:

	Në %
Mobiliet	20
Pajisjet elektronike	25

#### 3.3 Konvertimi nga Monedha e Huaj

AAB përdor si monedhë bazë Lek-un (ALL). Të gjithë kontributet dhe pjesa dërrmuese e shpenzimeve janë në Lek (ALL). Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit.

#### 3.4 Tatimet dhe Taksat

AAB është një shoqëri jo fitimprurëse dhe si e tillë është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në Shqipëri. AAB është subjekt i tatimit në burim, i tatimit mbi të ardhurat personale dhe i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

#### 4. Arka dhe Banka

Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Arka	398,294	5,673
Banka	6,644,544	7,641,502
<b>Totali</b>	<b>7,042,838</b>	<b>7,647,176</b>

Banka përbëhet nga sa më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Llogari në LEK, pranë BKT	5,188,420	5,292,090
Llogari në LEK, pranë Union Bank	618,247	287,555
Llogari në EUR, pranë BKT	772,917	1,760,882
Llogari në LEK, pranë Veneto Banka	64,960	300,975
<b>Totali</b>	<b>6,644,544</b>	<b>7,641,502</b>

#### 5. Shpenzime të Parapaguara

Shpenzimet e parapaguara përfaqësojnë kryesisht pagesën e anëtarësimit të Shoqatës pranë BACEE në shumën LEK 531,137, si dhe parapagime për abonime e regjistrime vjetore, si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Kuotë Anëtarësimi e parapaguar BACEE	531,137	520,633
Abonim Financial Times	-	42,964
Abonim ABCOM (internet)	11,074	10,824
Hostim Domain aab.al	8,431	
Sigurim Shëndetësor SIGAL UNIQA GROUP	148,200	
<b>Totali</b>	<b>698,843</b>	<b>574,421</b>

#### 6. Arkëtime

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2013 përbëhen nga tarifa trajnimi të pagueshme nga bankat anëtare për pjesëmarrjen e punonjësve të tyre në trajnimet e organizuara nga Shoqata gjatë Dhjetorit 2013, si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Kuotë anëtarësimi T4 2012 - Procredit Bank	0	293,250
Tarifë Trajnimi - Alpha Bank Albania	50,288	
Tarifë Trajnimi - Fibank Albania	50,313	
Tarifë Trajnimi - Banka NBG Albania	50,313	
Tarifë Trajnimi - ProCredit Bank	50,313	
Tarifë Trajnimi - Tirana Bank	51,013	
Tarifë Trajnimi - Union Bank	50,313	
<b>Totali</b>	<b>302,554</b>	<b>293,250</b>

## 7. Aktivitet e Qëndrueshme

Aktivitet e Qëndrueshme përbëhen nga sa më poshtë:

Në LEK	Mobilie / Orendi	Pajisje Elektronike	Totali
<b>Kosto</b>			
Në 31 Dhjetor 2012	<b>1,966,078</b>	<b>1,092,323</b>	<b>3,058,401</b>
Shtesat gjatë vitit 2013	8,990	71,830	80,820
Pakësimet gjatë 2013	-	(140,907)	(140,907)
<b>Në 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,975,068</b>	<b>1,023,246</b>	<b>2,998,313</b>
<b>Amortizimi i Akumuluar</b>			
Në 31 Dhjetor 2012	<b>1,245,751</b>	<b>789,827</b>	<b>2,035,578</b>
Amortizimi gjatë vitit 2013	131,414	86,385	217,798
Pakësimet gjatë 2013	-	(109,576)	(109,576)
<b>Në 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,377,165</b>	<b>766,636</b>	<b>2,143,801</b>
<b>Vlera Neto e Librit</b>			
<b>Në 31 Dhjetor 2012</b>	<b>685,790</b>	<b>275,796</b>	<b>1,022,823</b>
<b>Në 31 Dhjetor 2013</b>	<b>597,903</b>	<b>256,610</b>	<b>854,513</b>

## 8. Detyrime ndaj Bankave

Viti 2013 është mbyllur pa detyrime ndaj bankave.

## 9. Llogari të Pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Pagesa tatim paga/sigurimesh	266,075	252,387
Pagesa utilitetesh	65,675	481,112
Pagesa tatimi ne burim	24,957	6,378
Fatura të pambërritura (energji, ujë, ngrohje)	75,718	56,982
<b>Totali</b>	<b>432,425</b>	<b>796,859</b>

## 10. Të Ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2013 dhe 2012 janë si vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Nga kuotizacionet e Bankave Anëtare	33,001,000	33,001,000
Të ardhura nga donacionet	-	-
Të ardhura të tjera	6,576,113	7,636,431
<b>Totali</b>	<b>39,577,113</b>	<b>40,637,431</b>

Me vendim Asambleje Nr. 6, datë 31.05.2011, bankat anëtare paguajnë shuma të ndryshme, në proporcion me përqindjen që zënë asetet e tyre në totalin e aseteve të sistemit bankar (kuotë proporcionale), me një vlerë minimale të kuotave prej 1.000.000 Lek.

Të ardhurat e tjera përfshijnë kryesisht tarifa trajnimesh të organizuara nga AAB.

## 11. Shpenzimet e Përgjithshme dhe të Administrimit

Shpenzimet e përgjithshme dhe të administrimit në 2013 dhe 2012 përbëhen nga sa vijon:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shpenzime personeli	10,329,521	8,618,048
Shpenzime të tjera të administrimit	29,233,937	32,241,402
<b>Totali</b>	<b>39,563,458</b>	<b>40,859,450</b>

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Paga	8,348,468	7,290,857
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	865,659	750,796
Shpërblime	671,394	576,395
<b>Totali</b>	<b>9,885,521</b>	<b>8,618,048</b>

Shpenzimet e tjera të administrimit paraqiten si më poshtë:

Në LEK	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2013	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2012
Shërbime utilitare	5,420,068	5,250,971
Shpenzime trajnimi për Bankat Anëtare	6,273,000	10,186,838
Shpenzime organizative	4,544,251	5,284,014
Reklama dhe internet	4,706,957	7,231,518
Shpenzime zyre	1,525,394	1,412,173
Shërbime konsulence	6,628,891	2,744,217
Komisione & tarifa bankare	125,255	121,552
Taksa vendore	10,120	10,120
<b>Totali</b>	<b>29,233,937</b>	<b>32,241,402</b>

## 12. Fitim / humbja nga kursi i këmbimit

Nga diferenat në kurset e këmbimit, gjatë vitit 2013 janë realizuar humbje prej LEK 39,013.

## PUBLIKIME PERIODIKE GJATË VITIT 2013

### Botimi i 6-të, 7-të, 8-të dhe 9-të i Revistës Bankieri

Sekretariati i AAB-së shpërndau në Janar, Prill, Korrik dhe Tetor 2013 katër botime të reja të revistës Bankieri, për të gjithë komunitetin bankar, institucionet shtetërore, Universitetet publike e private, organizata ndërkombëtare në Shqipëri e jashtë saj, media dhe shoqata të tjera bankare në rajon. Versionet Shqip dhe Anglisht të revistës janë të aksesueshme nga publiku në faqen e internetit të AAB-së.

### Statistika

AAB publikoi në faqen e internetit të dhënat financiare të paaudituar të treguesve kryesorë të sistemit bankar sipas standardeve SNRF, si dhe të dhëna të agreguara për të gjithë sistemin. Statistikat tremujore u shoqëruan edhe me njoftime për shtyp të shpërndara në media.

### Raporti Vjetor

Sekretariati i AAB-së përgatiti dhe publikoi e shpërndau në fund të Korrikut Raportin Vjetor të AAB-së 2012. Të dhënat financiare të AAB-së për vitin 2012 u audituan nga Fibank Shqipëri, sipas rotacionit në rend alfabetik ndërmjet bankave anëtare.

### Lajme Mujore

Sekretariati ka informuar të gjithë bankierët, në nivel manaxherial e teknik, nëpërmjet një njoftimi mujor, mbi të gjitha aktivitetet e AAB-së .

### Lista e deklarave për shtyp lëshuar nga AAB gjatë 2013

**6 Shkurt 2013:** Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) zgjedh Kryetarin dhe tre anëtarë të rinj të Bordit Drejtues

**18 Shkurt 2013:** Zhvillimet në sistemin bankar

**20 Mars 2013:** Shoqata Shqiptare e Bankave, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit orgazojnë aktivitetin me temë “Rëndësia e edukatës financiare”, në kuadër të javës ndërkombëtare të edukimit financiar

**25 Prill 2013:** Qëndrimi i bankave dhe AAB në lidhje me masat rregullative dhe ligjore mbi kreditimin dhe kreditë me probleme

**17 Maj 2013:** AAB organizon Forumin Kombëtar Shqiptar të Kartave

**22 Maj 2013:** Zhvillimet në sistemin bankar – Statistikat Mars 2013

**24 Maj 2013:** Tryezë diskutimi “Mbi përmirësimin e raportimit të bankave në kuadrin e luftës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”

**28 Maj 2013:** Heqja e pengesave për rritjen e sektorit të energjisë së rinovueshme në Ballkanin Perëndimor

**31 Maj 2013:** AAB organizon Forumin Kombëtar për Sigurinë Bankare

**12 Nëntor 2013:** Zhvillimet në sistemin bankar – Statistikat Shtator 2013

**20 Nëntor 2013:** Edukimi financiar – paketa mësimore “ 1,2,3 ... Derrkuci Çufo mëson të kursejë”

